



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:047343
Datë: 13.09.2024
Numri i dokumentit: 06159905

Pml.nr.546/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit B. V., për shkak të veprës penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, nga neni 138, paragrafi 1 lidhur me veprën penale “Trajnimi për terrorizëm”, nga neni 133 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.46/2023, të datës 05.03.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, APS.nr.29/2024, të datës 08.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 10.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.V., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.46/2023, të datës 05.03.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, APS.nr.29/2024, të datës 08.07.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjyqimin PS.nr.46/2023, e datës 05.03.2024, të dënuarin B. V., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës

së Kosovës”, nga neni 138, paragrafi 1 të KPRK-së lidhur me veprën penale “Trajnimi për terrorizëm”, nga neni 133 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vjet e gjashtë (6) muajve, në të cilin dënim, të dënuarit do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 21.02.2023. Nga i dënuari është konfiskuar shuma e të hollave prej dymijepesëqind (2,500.00) euro, si pasuri e specifikuar në aktakuzë, e cila shumë e të hollave kishte qenë e dedikuar për furnizim me material për kryerjen e akteve terroriste. Ndaj të dënuarit, konform nenit 366, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), është vazhduar paraburgimi derisa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar. Është detyruar i dënuari që të paguajë shumën prej njëqind (100) euro në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe shumën prej njëqind (100) euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.29/2024, e datës 08.07.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit, avokati Arben Kelmendi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që këto aktgjykime të anulohen, ndërsa kjo çështje penale t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.318/2024, e datës 05.09.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B. V., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi e vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit B. V., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimeve të kundërshtuara i mungon arsyetimi në lidhje me pjesën që ka të bëjë me veprën penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, ndërsa këto aktgjykime janë bazuar vetëm në deklaratimet e mëparshme të të dënuarit të dhëna në polici dhe prokurori, edhe pse i njëjti i ka mohuar këto deklaratime.

Gjithashtu, mbrojtësi pretendon se në këtë rast nuk është arsyetuar se kush ishte personi - identiteti i tij që ka marrë trajnim këtu i dënuari, a ka qenë ky person i kualifikuar apo a ka pasur njohuri për armët artizanale për të dhënë trajnim. Në anën tjetër, e konteston edhe

ligjshmërinë e sigurimit të disa provave, përkatësisht disa bisedave të zhvilluara në rrjetet sociale, të cilat prova do të duhej të shpallehin si të papranueshme, pasi që kanë të bëjnë me periudhën kohore para datës së marrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve, përkatësisht para datës 22.02.2023.

Përveç këtyre, thekson se më rastin e marrjes së aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka bërë ricilësimin e veprës penale, i cili ricilësim e rëndon pozitën juridike të të dënuarit, pasi që dënueshmëria është më e lartë, ndërsa në pjesët tjera të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të dënuarit i konteston aspektet tjera që ndërlidhen me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit B. V., janë të pabazuara, pasi që aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit.

Fillimisht, Gjykata Supreme e Kosovës gjen që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban ndonjë të metë, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit. Në dispozitiv të aktgjykimit në fjalë janë paraqitur në mënyrë të qartë veprimet kryerëse të të dënuarit, të cilat si të tilla janë në harmoni edhe me ricilësimin juridik të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa në arsytimin e këtij aktgjykimi janë paraqitur dhe elaboruar në mënyrë të qartë dhe mjaftueshme provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, e mbi bazën e të cilat, gjykata me të drejtë ka konkluduar se i dënuari është kryerës i kësaj vepre penale. Jo vetëm sa i përket përgjegjësisë penale të të dënuarit, por që në arsytimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur mjaftueshëm arsye edhe sa i përket çështjeve tjera të rëndësishme, duke përfshirë këtu: analizimin dhe vlerësimin e duhur dhe të hollësishëm të të provave të administruara, paraqitjen e arsyeve përkitazi me ricilësimin juridik veprës penale, dënimit të shqiptuar, konfiskimit, etj. Nga arsytimi i aktgjykimit në fjalë rezulton se jo vetëm deklaratimet e të dënuarit të dhëna para zyrtarëve policor dhe para prokurorit të shtetit kanë qenë prova mbi bazën e të cilave është mbështetur gjykata e shkallës së parë kur ka gjetur se është provuar përtej dyshimit të bazuar fajësia e të dënuarit, por që janë edhe një mori provash tjera që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, dëshmitë e disa dëshmitarëve, provat materiale që janë dorëzuar nga autoritetet e shtetit të Francës, raporti i të gjeturave me rastin e bastisjes së banesës së të dënuarit, raportet e ekzaminimit të pajisjeve telefonike me video përkatëse, komunikimet inkriminuese në drejtim të krijimit të materieve eksplozive dhe destinacionet e gjuajtjes në sheshet e Prishtinës, vërtetimet dhe procesverbalet përkatëse, fotografitë, raporti njoftues mbi analizën e ekzaminimit të pajisjes - aparatit telefonik "Samsung ...", DVD-ja me të dhënat e nxjerrja nga pajisjet e ekzaminuara dhe provat tjera materiale që gjenden në shkresa të lëndës. Po ashtu, nga e gjithë përmbajtja e këtyre provave dhe dëshmimeve, e sidomos nga ekzaminimet e pajisjeve elektronike, fotove, videove, fjalimeve, si dhe materialeve tjera që gjenden në shkresa të lëndës, në arsytimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të qartë është arsyetuar se i dënuari ishte përkrahës i ideologjisë dhe veprimeve terroriste të kryera nga Organizata Terroriste

“ISIS”. Andaj, edhe në këtë mënyrë, rezulton se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me të gjitha çështjet dhe faktet e rëndësishme, ndërsa deklaratimet e mëparshme të të dënuarit, nuk kanë qenë provat e vetme mbi bazën e të cilave është bazuar fajësia e tij, kështu që pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Pavarësisht faktit që nuk janë prova të vetme mbi bazën e të cilave është bazuar fajësia e të dënuarit, megjithatë Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si deklarata e marrjes në pyetje të të dyshuarit e datës 22.02.2023, në Policinë e Kosovës, ashtu edhe marrja e deklaratës nga i pandehuri në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës më datën 02.05.2023, janë realizuar me prezencën e avokatit mbrojtës të të dënuarit, avokatit Arbër Shala, ku i dënuari, paraprakisht ishte njoftuar dhe udhëzuar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij sipas KPP-së dhe gjithashtu, i dënuari kishte deklaruar se i kupton të gjitha këto të drejta dhe detyrime, duke shtuar se dëshiron që të deklarohet dhe të përgjigjet në pyetjet e parashtruara, kurse pas përfundimit të këtyre veprimeve hetimore, nuk rezulton që i njëjti apo mbrojtësi i tij të kenë pasur ndonjë vërejtje apo mos pajtim në këto aspekte.

Përndryshe, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për të ekzistuar vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari, nuk është e domosdoshme që të dihet dhe të zbulohet identiteti i personit që ofron trajnime për terrorizëm, siç nuk është edhe e domosdoshme që personi i tillë të jetë i kualifikuar për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve të tilla. Por, që e rëndësishme në kuptim të figurës së veprës penale është që personi i tillë të ndërmerr ndonjërin prej veprimeve të përcaktuara në nenin 133 të KPRK-së. Në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se këtë veprë penale e kryen si personi që ofron trajnim për terrorizëm, ashtu edhe personi që pranon trajnim për terrorizëm, kurse, shprehja “trajnim për terrorizëm”, sipas paragrafit 2 të këtij neni, nënkupton trajnimin ose udhëzimin, përfshirë ofrimin ose pranimin e njohurive ose aftësive praktike, për prodhimin ose përdorimin e mjeteve shpërthyesë, armëve të zjarrit ose armëve tjera apo substancave kimike, bakteriologjike, nukleare apo substancave të tjera të dëmshme apo helmuese për njerëzit, pronën apo mjedisin, ose me metoda apo teknika tjera specifike, me qëllim që të kryejë apo të kontribuojë në kryerjen e veprës terroriste, duke ditur se shkathtësitë e mësuara apo të marra kanë për synim që të përdoren për këtë qëllim. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në veçanti nga komunikimet e të dënuarit me personin “A. M.” dhe nga sqarimet e dhëna në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezultojnë qartë veprimet e të dënuarit të cilat i përbëjnë të gjitha elementet e veprës penale të lartcekur. Në këtë mënyrë, nga provat e lartcekura, i dënuari i kishte sqaruar personit të lartcekur se ai po planifikon dhe po organizon personat tjerë, ku i tregon se ai në Kosovë nuk rrinë me persona tjetër, përveç me personin e quajtur “...” (i cili rezulton që të ishte B. K.), si dhe i sqaron se këto plane i din vetëm “...”, por edhe dy persona tjetër në Kosovë, nëse i bashkëngjiten planit të tij, pra vetë i dënuari i tregon personit të quajtur “A. M.” planin e tij që ka për sulm ndaj komunitetit LGBT dhe gjithashtu e njofton se ai e ka si qëllim që t’i organizojë edhe personat tjerë, nëse ata do t’i bashkohen, kurse nga personi “A. M.”, i dënuari kishte kërkuar udhëzime dhe kishte pranuar udhëzime - njohuri praktike, për prodhimin e mjeteve shpërthyesë, armëve me substanca kimike dhe bombave, me ç’rast ky personi i lartcekur e mëson të dënuarin hap

pas hapi se si duhet të krijohen këto armë, duke siguruar fillimisht listën e gjërave që nevojiten për të bërë eksplozivët, ndërsa më pastaj i dënuari disa prej gjërave edhe i kishte blerë, kurse për disa produkte tjera ishte në kërkim.

Gjykata Supreme e Kosovës i konsideron si të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit në lidhje me ligjshmërinë e provave, duke konstatuar se në këtë rast nuk bëhet fjalë për prova të papranueshme, në radhë të parë, për faktin se disa prova materiale, janë siguruar duke respektuar rrugët formale dhe procedurale, ashtu siç parashihet në nenin 215 të KPP-së, për faktin se të njëjtat prova janë sjell nga autoritetet e shtetit të Francës, duke e pasur parasysh se i dënuari kishte vendqëndrim në këtë shtet dhe banesa e tij, i është nënshkruar një kontrolli nga autoritet policore të këtij shteti.

Nga shkresat e lëndës, del që pas marrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve, janë ndërmarrë një sërë veprimesh hetimore, duke përfshirë këtu edhe ekzaminimin e pajisjeve nga organet kompetente sipas urdhrave të ligjshme, andaj edhe fakti që në këto pajisje elektronike janë gjetur biseda dhe komunikime që i përkasin periudhës para fillimit të hetimeve, nuk do të thotë që provat e tilla janë të papranueshme.

Edhe pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit në lidhje ricalësimin juridik të veprës penale janë të pabazuara, sepse veprimet e të dënuarit B. V., i përbëjnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, të cilat veprime janë të përshkruara në mënyrë të hollësishme në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe se në këtë rast, nuk është rënduar pozita juridike e të dënuarit, si rezultat i ricalësimit juridik të veprës penale, për shkak të dënueshmërisë më të lartë.

Qëndron fakti se i dënuari B. V., fillimisht ishte akuzuar për shkak të veprës penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, nga neni 138, paragrafi 1 lidhur me veprën penale “Kryerja e veprës terroriste”, nga neni 129, paragrafi 1 të KPRK-së, mirëpo pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, gjykata e shkallës së parë e kishte ricalësuar veprën penale dhe të dënuarin në fjalë e kishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, nga neni 138, paragrafi 1 lidhur me veprën penale “Trajnimi për terrorizëm”, nga neni 133 të KPRK-së.

Në lidhje me situatat e tilla, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se vepër penale themelore mbi bazën e së cilës shqiptohet dënimi është vepra penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, nga neni 138, paragrafi 1 të KPRK, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet, e cila vepër penale për shkak të natyrës së saj ka karakter udhëzues apo të ashtuquajtur “blanket”, pasi që në lidhje me elementet e figurës së kësaj vepre penale i referohet veprave penale nga nenet 128-137 të KPRK-së. Pra, në raste të tilla, pavarësisht faktit se cilës vepër penale i referohet (e në këtë rast, veprës penale nga nenet 129 apo 133), prapë se prapë, dënimet shqiptohet sipas dispozitës ligjore të nenit 138, paragrafi 1 të KPRK-

së, e cila vepër penale konsiderohet se kryer, përkatësisht e përfunduar me vetë faktin e ndërmarrjes së veprimeve të caktuara përgatitore.

Në fund, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përmban edhe pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.546/2024, më datë 10.09.2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Valdete Daka